



PËR
PERIUDHË
N MAJ 2023
– JANAR
2025

RAPORT

ANALIZË STATISTIKORE PËR HETIMIN E KRIMIT
ZGJEDHOR

Publikuar më 14 Prill 2025

**ANALIZË STATISTIKORE PËR HETIMIN E KRIMIT ZGJEDHOR
PËR PERIUDHËN MAJ 2023 – JANAR 2025**

Shënim: Analiza statistikore bazohet dhe mbështetet në të dhënat e vëna në dispozicion nga zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit (SPAK) dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO) gjatë periudhës së monitorimit. Për rrjedhojë, pasaktësitë apo inkonsistenca në mënyrën e evidentimit të numrit të çështjeve gjatë periudhave të ndryshme që është kërkuar informacion është përgjegjësi e vetë institucionit.

Autor: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Përgatiti:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Znj. Aulona Hazbiu, Eksperte, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ky raport është hartuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në kuadër të zbatimit të projektit “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike: Forcimi i rolit monitorues dhe kërkesës së llogarisë nga qytetarët nëpërmjet shoqërisë civile, medias dhe mbështetjes akademike”, financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar në partneritet me Instituti i Studimeve Politike (ISP), Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përcjell domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës Britanike.

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

PO BOX no.1752;

Tel: 04 2233671;

Cel: 0694075732;

E-mail: office@ahc.org.al

Web site: www.ahc.org.al

Table of Contents

1. Sfondi i hartimit të statistikave	3
2. Përmbledhje e gjetjeve	4
3. Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm	6
4. SPAK	9
5. GJKKO	11
6. Rekomandime	11

1. Sfondi i hartimit të statistikave

Monitorimi mbi ecurinë e hetimit të kallzimeve/procedimeve penale përfshin periudhën **pas zgjedhjeve vendore të mbajtura në datën 14 Maj 2023 dhe deri në datën Janar 2025**, pra për një kohëzgjatje totale **prej 21 muajsh**.

Gjatë kësaj kohe i është kërkuar informacion:

- (i) të gjithë zyrave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm përkatësisht: Tiranë, Durrës, Elbasan, Berat, Dibër, Shkodër, Lezhë, Kukës, Vlorë, Fier, Korçë, Gjirokastrë, Sarandë;
- (ii) Strukturës së Posaçme Anti Korrupsion (SPAK); si dhe
- (iii) Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO)

në tre periudha të barazlanguara nga njëra tjetra.

Tre periudhat janë të ndara si më poshtë vijon:



Kjo qasje ka mundësuar krijimin e një fushëpamje të qartë, në një periudhë afatgjatë, mbi ‘fatin’ e procedimeve penale të regjistruara dhe efektivitetin e ndjekjes penale në tërësi për këto vepra. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është kujdesur të marrë të dhëna të rifreskuar periodikisht dhe sistematikisht për të gjurmuar ecurinë e çështjeve sipas zyrave përkatëse.

Në periudhën e parë të monitorimit, fokusi i informacionit ishte më i gjerë dhe synonte të evidentonte jo vetëm a ka patur procedime penale për rastet e veprave penale të parashikuara në Kreun X të Kodit Penal “*Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve*”, por edhe të dhëna mbi subjektet, hetimet *ex officio*, si dhe fazat në të cilën ndodhen procedimet.

Pas përpunimit të informacionit bazë (*baseline*), **monitorimi në fazën e dytë dhe të tretë** u fokusua tek ecuria e hetimit, për të kuptuar shpejtësinë e hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor, rastet e pushimit si dhe shkallën e mosmarrëveshjeve të kompetencës midis prokurorive të juridiksionit të zakonshëm dhe SPAK.

2. Përmbledhje e gjetjeve

Nga analiza e të gjitha shifrave të raportuara gjatë 21 muajve, KShH vëren një trend të ngjashëm me dy fazat e mëhershme të monitorimit statistikor të krimit zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023 (megjithëse nuk përjashtohet mundësia e çështjeve në hetim për krimin zgjedhor në zgjedhjet e kaluara parlamentare të vitit 2021), si vijon:

- Numri i çështjeve të raportuara në total nga zyrat e prokurive të juridiksionit të zakonshëm dhe SPAK gjatë gjithë periudhës 21 mujore janë pothuajse të njëjta ku **SPAK raporton 43 përkundrejt 42 çështjeve që figurojnë të regjistruara në prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm**¹. Ngarkesa e SPAK është pak më shumë se të gjitha prokuroritë të marra së bashku. Në pamje të parë, këto shifra tregojnë një baraspeshë numerike mbi shpërndarjen e çështjeve.
- **Deri në Janar 2025, 54% e çështjeve në prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm dhe 44% në SPAK janë mbyllur** (vendosur mosfillimi apo pushimi i procedimit penal).
- Ndërkohë që rezulton se **ende janë 12 çështje në hetim nga zyrat e prokurorive të juridiksionit të zakonshëm, përkundrejt 22 çështjeve të raportuara si ende në hetim nga SPAK.**

KShH, bazuar edhe në studimin e mëhershëm të hetimit dhe ndëshkimit të krimit zgjedhor vlerëson se në tërësi, përtej rasteve apo praktikave pozitive që ka krijuar SPAK, sistemi i ndjekjes dhe hetimit penal për këtë kategori veprash mbetet ende joefektiv dhe është i vonuar në kohë. Si rezultat final, statistikatat tregojnë se në tërësi, krimet zgjedhore nuk ndërhshkohen. Arsytet që rezultuan nga analiza e të dhënave janë: mungesa e provave, denoncime janë të paplota ose të pabazuara (sidomos ato nga subjektet politike), fakti nuk konsiderohet vepër penale sipas ligjit, mungesë njohurish mbi vendime të ngjashme nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ose gjykatave që kanë krijuar precedent ligjor. Megjithatë, duke qenë se këto konkluzine bazohen vetëm në analizë të të dhënave statistikore, kjo nuk përjashton mundësinë që organi i prokurorisë, sikurse KShH ka vërejtur në të kaluarën të shfaqë mangësi në drejtim të hetimit objektiv, efektiv e të gjithëanshëm dhe të arsyeshëm në kohë.

Koha si faktor nuk ndikon pozitivisht në ecurinë e çështjes dhe trendin e dërgimit në gjyq. Kështu, prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm i rritën gjatë periudhës Mars 2024-Janar 2025 me 16.7% rastet e mbyllura, përkatësisht nga 18 në 21.

Në prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm, vetëm 14% e procedimeve penale për krimet zgjedhore arrijnë të dërgohen për gjykim. SPAK ka dërguar vetëm 6% të çështjeve në gjykim. Shifrat tregojnë një problem sistematik në hetimin/ndjekjen penale të këtyre veprave.

¹ Në këtë shifër nuk janë përfshirë çështjet e dërguara për kompetencë në SPAK që janë 8.

Deri në Janar 2025, vetëm në 4% të çështjeve gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka vendosur fajësinë e të pandehurve. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga GJKKO deri në Janar 2025, në tre raste të pandehurit janë deklaruar fajtor dhe dënuar me burg. Kjo përbën vetëm 7% nga totali i 43 çështjeve të raportuara nga SPAK. Në të dyja juridiksionet gjyqësore niveli i ndërshkueshmërisë mbetet tejtejt i ulët, edhe pse me një nivel pak më të lartë produktiviteti nga juridiksioni i posaçëm i hetimit dhe ndëshkimit të krimit zgjedhor.

Brenda periudhës Mars 2024-Janar 2025, SPAK përgjysmoi numrin e rasteve të dërguara për gjykim nga 2 në 1, ndërkohë që prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm e rritën numrin nga 3 në 8.

3. Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm

Të dhënat statistikore të analizuara tregojnë diferenca në performancën e prokurorive, ku prokuroria e Durrësit dhe Tiranës kanë ritëm të kënaqshëm në lidhje me ecurinë e çështjeve në hetim (për periudhën Mars 2024 - Janar 2025), përkundrejt prokurorive të juridiksionit të zakonshëm Kukës, Lezhë, Fier dhe Vlorë, të cilat nuk raportojnë zhvillime dhe mbeten në nivelet e raportuara në Mars 2024, edhe pse në total kishin më pak çështje. Kështu prokuroria e Fierit ka patur vetëm një çështje të cilën ende e ka në hetim. Disa prokurori si ajo e Beratit, Shkodrës, Dibër, Gjirokastrë raportojnë se nuk kanë më çështje në hetim për këtë kategori veprash penale.

Në kushtet kur zgjedhjet e përgjithshme parlamentare po afrojnë, mbartja e çështjeve penale nga zgjedhjet paraardhëse përbën element që jo vetëm nuk i shërben eficiencës së zyrës, por edhe nuk kontribon në rritjen e besimit të publikut në ndjekjen penale për këtë kategori veprash.

Disa prokurori paraqesin nivel transparence më të lartë në mënyrën se si e përcjellin informacionin e kërkuar, bazuar në tregues si plotësia, qartësia dhe kuptueshmëria e tij, kështu për shembull prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm Durrës apo Gjirokastrë. Problematike mbetet situata në prokurorinë e juridiksionit të zakonshëm Sarandë, e cila nuk ka ofruar informacion në të gjitha periudhat e monitorimit.

Më tej, informacioni që vihet në dispozicion nuk klasifikohet sipas veprës penale përkatëse brenda Kreut X². Klasifikimi/ndarja do të mundësonte analizë edhe mbi llojin e veprave penale për të cilat është vendosur mosfillimi, apo janë pushuar apo ato që janë dërguar për gjykim me qëllim për të kuptuar më mirë se cilat janë ato vepra që kryhen më shpesh. Sa më sipër, përbën kufizim në analizën e të dhënave dhe vlerësimin e tyre tërësor. Pavarësisht këtij kufizimi, për aq sa është e

² Ky Kre përmban 15 vepra penale.

mundur të evidentohet nga të dhënat e përfutuara në tërësi, rezulton kjo shpërndarje/shpeshtësi e veprave penale:

<i>Neni 248 Shpërdorimi i detyrës</i>	<i>Neni 326/a Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhësor</i>	<i>Neni 328 Korrupsion aktiv në zgjedhje</i>	<i>Neni 328/a Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore</i>	<i>Neni 328/b Korrupsion pasiv në zgjedhje</i>	<i>Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje</i>	<i>Neni 330 Pengimi i zgjedhësve</i>	<i>Neni 331/a Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit</i>
3	1	9	5	2	3	4	2

Në shumicën e rasteve këto vepra penale hetohen së bashku apo të ndërlidhura si më poshtë:

- nenet 328 (Korrupsion aktiv në zgjedhje), 328/a (*Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore*) të K.Penal;
- nenet 328 (Korrupsion aktiv në zgjedhje), 329 (*Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje*) të K.Penal
- nenet 330 (*Pengimi i zgjedhësve*) dhe 331/a (*Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit*) të K.Penal.

Kjo ndërthurje tregon një tendencë apo tipologji sipas të cilës funksioni publik përdoret për veprimtari politike ose zgjedhore, që përmban edhe elementë të korrupsionit aktiv. Ngjashmërisht, edhe pengimi i zgjedhësve gërshetohet me marrjen ose përdorimin e paligjshëm të dokumenteve të identifikimit.

Evidentohet se nga 50 procedime penale të raportuara nga prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm prej të cilave 8 i kanë kaluar SPAK, deri në Mars 2024, afro një vit pas zgjedhjeve të qeverisjes vendore, për 18 çështje ose afro 1/3 e tyre ishte vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Tabela më poshtë pasqyron statusin e të dhënave deri deri Janar 2025.

	Prokuroria	Nr total i kallzimeve /procedimeve	Vendosur mosfillim procedimi penal	Në proces hetimi	Pushuar	Dërguar për gjykim	Dërguar për kompetencë SPAK
1	Tiranë	12 (3 janë pezulluar)	8	1		2	1
2	Durrës	9	2	1	4	1	-
3	Elbasan	7 (1 pezulluar ridërguar policisë)	2	1	1	1	-
4	Berat	Nuk ka më asnjë çështje në hetim nga 4 që kishte fillimisht			2		2
5	Dibër	Nuk ka më asnjë çështje në hetim nga 4 që kishte fillimisht	3				1
6	Shkodër	Nuk ka më asnjë çështje në hetim nga 3 që kishte fillimisht			2		1
7	Lezhë	Ka ende të vetmen çështje në hetim		1			
8	Kukës	Nuk ka më asnjë çështje në hetim nga 5 që kishte fillimisht	3			1	1
9	Vlorë	Nga 3 çështje që kishte fillimisht, 2 janë ende në hetim		2			1
10	Fier	Nga 2 çështje që kishte fillimisht, 1 është ende në hetim		1			1

11	Korçë	Nuk ka më asnjë çështje në hetim nga 1 që kishte fillimisht				1	
12	Gjirokastrë	Nuk ka më asnjë çështje në hetim nga 1 që kishte fillimisht				1	
13	Saranda	Nuk ka asnjë procedim penal					
	Status Mars 2024	50³	18	19 (7)	4 (9)	3 (7) -2 vendime fajësije	8
	Status Janar 2025			12 çështje në hetim ende			

Shënim: Tabela hartuar nga Komiteti Helsinki mbi të dhënat e vëna në dispozicion

4. SPAK

Të dhënat e analizuara gjatë të tre periudhave kohore reflektojnë ndryshime të ndjeshme në fluksin e çështjeve në sidomos midis periudhës Mars 2024 dhe Janar 2025. Kështu deri në datën 31.03.2024 raportohen se kanë mbetur në hetim 15 çështje, ndërkohë që në periudhën pasardhëse, Janar 2025 raportohen 22 çështje në hetim. Në raportimin e Janarit 2025, evidentohen 43 procedime penale (mbartur dhe regjistruar) në total përkundrejt numrit 19 që raportohet në Mars 2024. Në raportimin e parë, Tetor 2023 është evidentuar se në 6 çështje është vendosur mosfillim procedimi penal. Në total, 8 çështje kanë kaluar nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm për kompetencë tek SPAK.

Nga analiza e numrave të raportuar rezulton që në më pak se një vit, kemi një rritje të numrit të procedimeve penale nga 19 në 43, pra ky numër është më shumë se sa dyfishuar. Referuar raportimit këto janë çështje të mbartura dhe regjistruara. Kjo tregon një rritje të aktivitetit të ndjekjes penale për krimet zgjedhore dhe arsyet e kësaj difference mbeten të paqarta. Sa më sipër, mund të tregojë që janë hapur procedime të reja penale për raste që nuk ishin në hetim më parë

³ Duke qenë se Prokuroria Shkodër raporton 3 procedime në raundin e dytë (Mars 2024), përkundrejt 2 procedimeve të raportuara në raundin e parë (Tetor 2023), numri total është tashme 50 procedime.

apo mund të jenë shtuar si rrjedhojë e mungesës së kompetencës nga zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

Po ashtu edhe numri i çështjeve në hetim është rritur me 47%. Mbetet e paqartë se sa nga këto çështje lidhen me zgjedhjet vendore të 14 Majit 2023 dhe sa janë nga ato që mund të kenë lidhje me zgjedhjet parlamentare të vitit 2021.

Gjithashtu mbetet e paqartë cila është arsyeja përse në këtë hark kohor po regjistrohen më shumë çështje në hetim se sa po mbyllen.

Edhe në rastin e SPAK evidentohet se ka ende shumë çështje të pambyllura nga zgjedhjet e Majit 2023 dhe mbase edhe ato paraardhëse të 2021, ndërkohë që po afrohen zgjedhjet e përgjithshme të 11 Majit 2025. Situatë krijon premisa për një ‘backlog’ të çështjeve për krimet zgjedhore që e vendos SPAK përpara sfidave për adresimin e saj. Mbetet për tu vlerësuar më tej efekti i ngritjes dhe funksionimit të Task Forcës së SPAK në adresimin e këtij backlogu.

Tabela 1: SPAK: Status: Tetor 2023

Tabela përmbledhëse vepra penale parashikuar nenet 328 si dhe 328/b të K.Penal					
Prokuroria:	Nr total i kallzimeve /procedimeve	Vendosur mosfillim procedimi penal	Në proces hetimi	Dërguar për gjykim	Hetim proaktiv
SPAK	29	6	20	3	0

Tabela 2: SPAK: Status: Mars 2024

Prokuroria:	Nr total i kallzimeve /procedimeve	Në proces hetimi	Dërguar për gjykim	Hetim proaktiv
SPAK	19	15 (2 të ardhura nga prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm)	2	0

Tabela 3: SPAK: Status: Janar 2025

Tabela përmbledhëse vepra penale parashikuar nenet 328 si dhe 328/b të K.Penal

Nr total i kallzimeve /procedimeve	Procedime të pezulluara	Dërguar në gjykatë për vendim pushimi	Në proces hetimi	Dërguar për gjykim	Transferuar për kompetencë zyrat e prokurive të juridiksionit të përgjithshëm
43	2	13	22	1	5

5. GJKKO

Për periudhën **Mars 2024 - Dhjetor 2024**, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar raportohet të jenë dhënë 4 (katër) vendime për veprën penale “*Korrupsion aktiv në zgjedhje*”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal dhe asnjë vendim për veprën penale “*Korrupsion pasiv në zgjedhje*”, parashikuar nga neni 328/b i Kodit Penal.

Në të treja rastet, të pandehurit janë deklaruar fajtor. Aktualisht, pranë kësaj gjykate nuk po shqyrtohet në themel asnjë dosje penale për veprat penale “*Korrupsion aktiv në zgjedhje*” dhe “*Korrupsion pasiv në zgjedhje*”, parashikuar nga nenet 328 dhe 328/b i Kodit Penal. Ndërsa veprat e tjera penale, të parashikuara në Kreun X të Kodit Penal, nuk janë në kompetencën lëndore të kësaj gjykate, sipas nenit 75/a të K.Pr.Penale.

6. Rekomandime

- Komiteti Shqiptar i Helsinkit sugjeron që në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të rritet numri i hetimeve proaktive nga SPAK dhe prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm, duke mos u mbështetur vetëm tek denoncimet. Në këtë drejtim, shpresojmë që do kontribuojë pozitivisht ngritja dhe funksionimi i Task Forcës së ngritur nga SPAK.
- KShH sugjeron rritjen e transparencës në lidhje me arsyet e vendimeve për mosfillimin dhe pushimin e procedimit penal, për të kuptuar më mirë ‘pse’ mbylljen çështjet.
- Ne vlerësojmë se është e nevojshme rritja e bashkëpunimit midis SPAK dhe zyrave të prokurorive të zakonshme për të shmangur konfliktet e kompetencave që përbëjnë në thelb ‘humbje kohe’ që zbeh efektin e ndjekjes penale. Rastet e analizuara tregojnë jo pak raste të ‘ping pongut’ që në fund marrin zgjidhje me vendim pushimi apo mosfillimi të procedimit.
- KShH rekomandon rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale për këtë kategori veprash, duke patur parasysh “mësimet e marra” nga zgjedhjet e shkuara. Kjo mund të kërkojë jo vetëm një trupë/njësi prokurorësh për hetimet e këtyre vepve para/gjatë dhe disa muaj pas

zgjedhjeve, por edhe zbatimin e mekanizmave të tjerë që sigurojnë hetim të shpejtë dhe çështje që dërgohen për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

- Së fundmi, rekomandojmë rritjen e transparencës mbi ndjekjen penale për zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve (Kreu X i Kodit Penal) si dhe forcimin e kapaciteteve në lidhje me cilësinë e raportimeve duke evidentuar/kategorizuar llojin e veprës, ecurinë e çështjes në gjykatë në një mënyrë të kuptueshme si elementë që i shërbejnë analizës cilësore dhe sasiore të ndjekjes penale në tërësi nga ana e shoqërisë civile.

Ky raport është hartuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në kuadër të zbatimit të projektit “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike: Forcimi i rolit monitorues dhe kërkesës së llogarisë nga qytetarët nëpërmjet shoqërisë civile, medias dhe mbështetjes akademike”, financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar në partneritet me Instituti i Studimeve Politike (ISP), Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përcjell domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës Britanike dhe organizatave partnere të zbatimit të kësaj nisme.